



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I KURRIKULËS VLERËSIMIT INSTITUCIONAL DHE ALUMNI

Nr. 1457 prot.

Korçë, më 10/09/2021

RELACION PËR PYETËSORIN STUDENTOR

Në periudhën qershor-korrik 2021, anëtarët e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me sektorin e kurrikulës vlerësimit institucional dhe alumni kanë zhvilluar pyetësin studentor, pyetjet e të cilit janë hartuar dhe rishikuar sipas përcaktimeve ligjore.

Pyetësi është shpërndarë në adresat zyrtare të e-mailit të studentëve duke qenë se ato përdoren edhe për procesin mësimor dhe të gjithë studentët kanë akses.

Pas përfundimit të periudhës së caktuar për plotësimin e tij, të dhënat e mara janë filtruar sipas fakulteteve dhe u janë dërguar koordinatorëve të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë për secilin fakultet të cilët do të kenë mundësinë të bëjnë raportet përkatëse.

Përkatësisht pyetësi u plotësua nga **163** studentë pjesëmarrës, ku **129** studentë ishin nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, **17** nga Fakulteti i Ekonomisë, **12** nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe **5** nga Fakulteti i Bujqësisë. Nga të dhënat e mara u evidentuan disa çështje kryesore si më poshtë:

- Në një vështrim të përgjithshëm vihet re se numri i studentëve pjesëmarrës është shumë i ulët duke marrë parasysh se u është shpërndarë të gjithëve në adresat e tyre zyrtare të e-mailit po ashtu janë bërë edhe njoftimet përkatëse si edhe janë venë në dijeni edhe departamentet e të gjitha fakulteteve për të nxitur studentët në plotësimin e tij.
- Përsa i përket materialeve mësimore, ato janë vlerësuar me *shumë mirë* ose *shkëlqyeshëm* në masën 70-80%, po ashtu në të njëjtin nivel është edhe vlerësimi për performancën e pedagogëve.
- Mbi 60% e pjesëmarrësve kanë pohuar se nuk ka orë mësimore të pazhvilluara. Vlerësime pozitive janë dhënë edhe për praktikat mësimore ose profesionale.
- Nga përgjigjet e studentëve pjesëmarrës vihet re se përsa i përket sjelljes dhe mungesës së *komunikimit* me sekretaritet mësimore *apo për plotësimin e kërkesave*, janë përgjigjur me *keq* rreth 10% e pjesëmarrësve dhe e njëjta çështje është

përmendur sërish edhe në pjesën e pyetësorit ku studentëve u kërkohet të japin mendimë të tjera.

- Përmirësimi i marrëdhënieve dhe urës së komunikimit pedagog-student është po ashtu një tjetër çështje e përmendur në pjesën e pyetësorit ku studentëve u kërkohet të japin mendimë të tjera.
- Ndërsa përsa i përket pyetjeve rreth bibliotekave për *kërkesat e plotësuara ose ndihma që meret nga literautura* janë përgjigjur me *aspak* rreth 10% e pjesëmarrësve ose me *pak* rreth 40-44% e pjesëmarrësve.

Raporti përmbledhës i detajuar do të hartohet nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për çdo fakultet.

Spektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni
Evis Kapurani

